

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Bleona është gjallë!"/ Gjyshi rrëfen misterin e zhdukjes dhe dyshimet për familjen e Vlorës
ADRESA	https://lajmifundit.al/bleona-eshte-gjalle-gjyshi-rrefen-misterin-e-zhdukjes-dhe-dyshime-t-per-familjen-e-vlores-i1338668
BURIMI	lajmifundit.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 10:39:04 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 12:37:35 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0f39fb2c402c5bae368eebba87cbf96a68d0dd193b4c164b1e64c09d6f51fa64
TEKSTI	ca41cd729f13eb4076e685f7f1c7aa6b896801707ed8fd7f3d457a687993d314
PAMJA	85a1d3e330ca51b9d527c39a9d345cab74e589fb47c541a1d5dfc67728ddb12b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	1c7b09b5bc66d1b52997e6f49fe9ecee9c72c0d5929dd7ffb22a2f451cd28033
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9f67fd8f5341aacd98433415ae2bd1fabd75d8584ec60b7ea3d19ca47caca387
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/1c7b09b5bc66d1b52997e6f49fe9ecee9c72c0d5929dd7ffb22a2f451cd28033>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

"Bleona është gjallë!" / Gjyshi rrëfen misterin e zhdukjes dhe dyshimet për familjen e Vlorës

[Lexo lajmin e plotë](#) →

Mark Zuckerberg zbulon orën e tij të preferuar, modeli i shqiptarit Rexhep Rexhepit po 'çmend' koleksionistët

[Lexo lajmin e plotë](#) →

Rreth 16 milionë kg mish derri nga Brazili, BE e ndaloj, Shqipëria vazhdon të importojë me shumicë

[Lexo lajmin e plotë](#) →

Publikohet lista, ja emrat e restoranteve në Shqipëri që tregtuan djathin me bakterin e rrezikshëm "Listeria"

[Lexo lajmin e plotë](#) →

Braçe u çon karrotrecin shoferëve të "Bllokut": Denoncojini, nuk ka më o vëllai prit një sekondë

[Lexo lajmin e plotë](#) →

"Bleona është gjallë!" / Gjyshi rrëfen misterin e zhdukjes dhe dyshimet për familjen e Vlorës



LAJMI FUNDIT / 25 SEPTEMBER 2026, 12:37

Shpërndaje

AKTUALITET



Prej 16 vitesh, fati i Bleona Matës mbetet i pazbardhur. Vajza vetëm 6 vjeçe humbi gjurmët më 22 maj 2010 në Zapod të Kukësit, teksa ndodhej në zonën e kullotave së bashku me vajza të tjera të familjes. Që prej asaj dite, kërkimet dhe hetimet nuk kanë mundur të japin një përgjigje përfundimtare se çfarë ndodhi me të.

Rasti i Bleonës është rikthyer ndër vite në vëmendjen e opinionit publik, ndërsa dëshmi të ndryshme kanë hapur edhe pista të reja për zhdukjen e saj.

Një prej tyre lidhet me një familje në Vlorë, pistë që është kundërshtuar nga familjarët e përmendur dhe për të cilën, deri më tani, nuk është bërë publike një provë përfundimtare që të zbardhë fatin e vajzës.

Në emisionin "Me Zemër të Hapur" të moderatores dhe autores Evis Ahmeti, gjyshi i Bleona Matës, Zenel Mata, ka rrëfyer kujtimet e tij për ditën e zhdukjes. Ai tregon se atë ditë ndodhej duke kositur pranë shtëpisë dhe kishte parë Bleonën duke luajtur në mes të fshatit.

Më pas, pas njoftimit se vajza nuk ishte më aty, banorët u mobilizuan dhe nisën kërkimet, të cilat vijuan për ditë të tëra në zonën përreth.

Gjatë intervistës, Zenel Mata mohon të ketë pasur konflikte apo hasmëri me fqinjët dhe kundërshton dyshimet që janë ngritur ndaj familjes së tij. Ai flet gjithashtu për dëshmitë lidhur me një makinë që dyshohet se është parë në zonë ditën e zhdukjes dhe shpreh dyshimet e tij për familjen në Vlorë. Këto janë pretendime dhe dyshime të shprehura prej tij gjatë intervistës dhe jo fakte të provuara.

MOTI NE TIRANE

Tirana, Albania

POLITIKË

Edi Rama merr fjalën sot në OKB, çfarë do të thotë kryeministri përballë udhëheqësve të botës?

POLITIKË

Përplasja për Vlora Hysenin, Koçeku: Për kryeministrin katundi vend thashethemesh, për mua vendi ku mbahet fjala

TRENDING

8,500 dëshmi konkrete të mbështetjes financiare nga sigurimi shëndetësor në SIGAL

One Albania sjell inovacionin Wi-Fi 7 për internetin në shtëpi

LEXONI GJITHASHTU



Mark Zuckerberg zbulon orën e tij të preferuar, modeli i shqiptarit Rexhep Rexhepit po 'çmend' koleksionistët



Rreth 16 milionë kg mish derri nga Brazili, BE e ndaloj, Shqipëria vazhdon të importojë me shumicë



Publikohet lista, ja emrat e restoranteve në Shqipëri që tregtuan djathin me bakterin e rrezikshëm "Listeria"

Pas 16 vitesh, gjyshi thotë se ende beson se Bleona është gjallë. Në fund të rrëfimit, ai i drejton një apel mbesës së tij, duke kërkuar që, nëse ajo është gjallë dhe e dëgjon një ditë këtë intervistë, t'i japë familjes një shenjë se ndodhet gjallë.

INTERVISTA

Anila Ahmataj: Zoti Zenel, përshëndetje!

Zenel Mata (Gjyshi i Bleonës): Përshëndetje!

Anila Ahmataj: Si jeni? Si kaloni ju?

Zenel Mata (Gjyshi i Bleonës): Mirë, mirë domethënë.

Anila Ahmataj: Ndjesë për shqetësimin. Zoti Zenel, unë të mora se doja të të pyesja pak lidhur me situatat e fundit, me dëshmitë që janë dhënë në ekranet televizive, lidhur me Bleona Matën...

Zenel Mata (Gjyshi i Bleonës): Ahë...

Anila Ahmataj: Dhe do donim që të dëgjonim dhe versionin tuaj, se shpeshherë familja juaj përmendet gjatë intervistave që nëna e saj jep nëpër media.

Zenel Mata (Gjyshi i Bleonës): Po... Po... Po, çfarë ka?

Anila Ahmataj: Tani, çfarë mendimi keni ju lidhur me të gjitha ato deklarata të dhëna në studiot televizive ku ju automatikisht përfshihen nëpërmjet dëshmisë së saj?

Zenel Mata (Gjyshi i Bleonës): Nuk ka problem prej nesh. Inshallah gjendet! Të jep ndonjë lajm ndonjëri, po...

Anila Ahmataj: Ju besoni që do gjendet?

Zenel Mata (Gjyshi i Bleonës): Patjetër që besojmë. Sepse nuk kena probleme ne me asnjë, po vazhdon vajza...

Anila Ahmataj: Po ju vetë, zoti Zenel, çfarë mbani mend nga data 22 maj?

Zenel Mata (Gjyshi i Bleonës): Po çfarë me mbajt mend? Gjithçka, dita e errët.

Anila Ahmataj: Pse?

Zenel Mata (Gjyshi i Bleonës): Zi për ne ka qenë.

Anila Ahmataj: Çfarë kujtoni ju?

Zenel Mata (Gjyshi i Bleonës): Po çfarë me kujtu? Tani kanë kaluar shumë, shumë kohë kanë kaluar...



POLITIKË

Rama nesër në Asamblenë e Përgjithshme: Çfarë pritet të deklarojë kryeministri shqiptar përballë krerëve të botës?



POLITIKË

Çfarë po ndodh? Ndërpritet për herë të tretë seanca plenare pas përplasjeve në Kuvend

ME TE LEXUARAT

"Zbrazti karika'torin ndaj shqiptarëve që i hynë në shtëpi" – Mediat italiane: Jeta e "dyfishtë" e...
[Lexo lajmin e plotë](#)

Euron pëson rënien si asnjëherë më parë, me sa tregtohet sot, këmbimi valutor 23 shtator 2026
[Lexo lajmin e plotë](#)

Skandali "Xhaka" merr përmasa të tjera, mjekja del kundër kapitenit: E kam vaksinuar vetë
[Lexo lajmin e plotë](#)

Zbulohet e vërteta për Bleona Matën, avokati: E ëma në gjendje të rëndë! A ndodhet në Greqi?!...
[Lexo lajmin e plotë](#)

ndodhur...

Anila Ahmataj: Po ku keni qenë atë ditë, mbani mend? Ku jeni ndodhur atë ditë?

Zenel Mata (Gjyshi i Bleonës): Mua atë ditë kam qenë duke kositur afër shtëpisë.

Anila Ahmataj: Çfarë ndodhi më tej?

Zenel Mata (Gjyshi i Bleonës): E shikoja vajzën duke luajtur këtu te mesi i fshatit...

Anila Ahmataj: Po...

Zenel Mata (Gjyshi i Bleonës): Edhe merr në telefon goca, thotë: "A ka ardhur Bleona", thotë, "në shtëpi?" Edhe bëmë kontrollin nëpër fshat, i gjithë fshati u mobilizua, i gjithë, gati komuna, dolëm për ta kërkuar në mal.

Anila Ahmataj: Po...

Zenel Mata (Gjyshi i Bleonës): Edhe dy javë kemi kërkuar... edhe nuk gjetëm asgjë.

Anila Ahmataj: Bashkëshortja juaj ka dhënë dëshmi, ka parë një makinë atë ditë?

Zenel Mata (Gjyshi i Bleonës): Me sa më njoftuan paksa, ka kaluar një makinë e Vlorës me shpejtësi drejt për në Kukës. Kishin parë dy gra, ishin në makinë, po ishin të mbuluara, thotë, "me shami".

Anila Ahmataj: Kush e thotë këtë?

Zenel Mata (Gjyshi i Bleonës): Ato që kishin punuar, ata punëtorët nëpër arat.

Anila Ahmataj: Po bashkëshortja, gruaja juaj?

Zenel Mata (Gjyshi i Bleonës): Gruaja ka qenë edhe ajo në shtëpi. Ka parë një djalë, thotë, iku, thotë, pas vajzave si për mal, me flokë të gjata, i maskuar.

Anila Ahmataj: Po atë ditë, vajza juaj, halla e Bleonës, ka qenë me Bleonën?

Zenel Mata (Gjyshi i Bleonës): Atë ditë ka qenë ajo, ka qenë me lopë sipër.

Anila Ahmataj: Veç pa Bleonën?

Zenel Mata (Gjyshi i Bleonës): Jo, Bleona ka qenë duke luajtur këtej në mes të fshatit.

Anila Ahmataj: Po ajo vetë, vajza juaj, halla e Bleonës, çfarë tregon për ngjarjen ose për atë ditë?

Zenel Mata (Gjyshi i Bleonës): Po çfarë të tregojë... Erdhi Bleona, thotë, me ato vajzat e tjera, me Qamilen...Ishte duke ngrënë qershë, thotë, i dha bukë, thotë, me ngrënë. Në atë kohë, thotë, shikoj lopët, se kishin ikur larg. Edhe u nis, thotë, për të kthyer lopët. Kur u ktheva, nuk e gjeta Bleonën.

Anila Ahmataj: E kuptoj. Po ju vetë, zoti Zenel, keni pasur ndonjë konflikt të tipit hasmëri me fqinjët?

Zenel Mata (Gjyshi i Bleonës): Jo, jo, jo, jo, jo, jo.

Anila Ahmataj: Me komshinjtë, me fqinjët?

Zenel Mata (Gjyshi i Bleonës): Jo, mo jo, nuk kena pasur. Nuk kena pasur fare.

Anila Ahmataj: Po asaj kohe, cilat kanë qenë mendimet tuaja lidhur me largimin e Bleonës? Çfarë keni menduar ju vetë?

Zenel Mata (Gjyshi i Bleonës): Po çfarë të them unë tani? Është rrëmbyer ajo. E kanë marrë dikush...

Anila Ahmataj: Sepse në disa dëshmi të Bukuries thotë që ju keni pasur konflikte me fqinjët tuaj.

Zenel Mata (Gjyshi i Bleonës): Jo, dëgjo! Po. Konflikte me ato ku, me ato ne jemi një fis gati.

Anila Ahmataj: Keni pasur ndonjëherë konflikt me ata?

Zenel Mata (Gjyshi i Bleonës): Jo, mo jo, nuk kena pasur konflikt! Përkundrazi, dasmë me marrë e me dhënë bashkë kena pasur gjithmonë.

Anila Ahmataj: Po djali juaj si i ka pasur marrëdhëniet me Bukurien?

Zenel Mata (Gjyshi i Bleonës): Zamiri ka qenë gjithmonë në kurbet. Jo në Maqedoni, jo këtej. Kjo ka qenë në shtëpi. Çfarë të them unë tani? S'jam interesuar për ato problemet. Mirë kanë qenë, s'kanë qenë keq.

Anila Ahmataj: E kuptoj. Po vetë djali juaj është interesuar ndonjëherë për Bleonën?

Zenel Mata (Gjyshi i Bleonës): Jo, jo, jo, jo! Që kur ka humbur Bleona, ai nuk ka lidhje me të, as me një familje.

Anila Ahmataj: Pra nuk flet, nuk ka komunikim me djalin?

Zenel Mata (Gjyshi i Bleonës): Jo, jo!

Anila Ahmataj: Po pse ka ndodhur kjo ftohje?

Zenel Mata (Gjyshi i Bleonës): Po pikërisht kjo ishte i gjithë hesap. Iku vajza... iku e Bukuriya...

Anila Ahmataj: E kuptoj. Po pse u ndanë, pse u divorcuan ata?

Zenel Mata (Gjyshi i Bleonës): Po ku e di unë tani, humbi vajza, Bukuriya iku, u ndanë ata.

Anila Ahmataj: Po ju, marrëdhënia juaj me Bukurien si është?

Zenel Mata (Gjyshi i Bleonës): Mirë ka qenë, mo mirë, unë s'kam ndonjë gjë kështu, ka qenë mirë. Unë bile, përkundrazi, me Bukurinë kam mbetur, kam shkuar atje për ta kërkuar, kudo.

Anila Ahmataj: Po, e di. Po me nipin ke komunikim?

Zenel Mata (Gjyshi i Bleonës): Me nipin rrallëherë shkoj tani në Kukës. Kur shkoj në Kukës atëherë e takoj, po.

Anila Ahmataj: Po ai si e ka sjelljen ndaj jush?

Zenel Mata (Gjyshi i Bleonës): Po rrallëherë, mirë është, mirë e ka, po...

Anila Ahmataj: Çfarë dyshon, çfarë dyshoni ju, zoti Zenel, dhe çfarë mendoni për këtë gjë? Cila është, domethënë, mendimi juaj apo shpresa që keni juve?

Zenel Mata (Gjyshi i Bleonës): Shpresa ime është që gjendet, do gjendet ajo Bleona.

Anila Ahmataj: Pra ju mendoni që është gjallë Bleona?

Zenel Mata (Gjyshi i Bleonës): Gjallë do jetë, gjallë, duhet të jetë doemos. Dëgjon? Dyshoj gjithmonë, gjithmonë te kjo familja e Vlorës.

Anila Ahmataj: Pse?

Zenel Mata (Gjyshi i Bleonës): Se ajo ka pasur dy goca, ka pasur ai. Goca e parë është martuar me një ushtar këtu. Edhe ajo, meqë s'paska pasur fëmijë, siç thuhet, ka ikur në Gjermani ku... kush e di ku... Duhet ta ketë marrë ajo.

Anila Ahmataj: Po pas gjithë kësaj zhurme që u bë me familjen e Vlorës, keni pasur ju ndonjë kontakt nga këta familjarë?

Zenel Mata (Gjyshi i Bleonës): Jo, mo jo, se ata janë në Vlorë ata. Ata s'kanë lëvizur hiç këtej.

Anila Ahmataj: Ju kanë telefonuar ndonjëherë për t'ju pyetur që çfarë është kjo dëshmi, pse na akuzoni?

Zenel Mata (Gjyshi i Bleonës): Jo, jo, jo, jo, jo, jo, jo! Ata s'kanë... asnjë lidhje ata. Akuza ka qenë vetëm se makina ka qenë e Vlorës edhe...

Anila Ahmataj: Po. Pra ju... ju po më thoni që dyshoni te kjo familje në Vlorë?